

**S**i nxënës shkolle, mua m’u prezantua teoria e evolucionit si një fakt shkencor i provuar, në klasat e edukimit fetar. Nuk ka dyshim se mësuesi, i cili nuk ishte shkencëtar, kishte qenë i sigurt se evolucioni ishte provuar dhe kërkonte me ndershmëri që të na ndihmonte ne për ta lidhur këtë aspekt të “shkencës moderne” me atë që na tregon Bibla për origjinën tonë. Jo shumë kohë pas kësaj, si student universiteti në fillim të viteve 1980-të, mua m’u prezantua një pikëpamje shumë e ndryshme, këtë herë nga një shkencëtar i shquar. Ai ishte Profesori E. H. Endrjus [E.H.Andrews], Shefi i Departamentit të Materialeve në Kolegjin “Queen Mary” të Universitetit të Londrës. Profesori Endrjus po fliste në një takim të Unionit Kristian dhe fjalimi i tij titullohej “A është Evolucionit Shkencor?” Shumë shpejt u bë e dukshme se, vetëm mbi baza shkencore, ai nuk e pranoi teorinë e evolucionit dhe besonte se shumë prej të menduarit evolucionist nuk ia dilte mbanë të zbatonte një metodë të mirë shkencore.

Nëpër dekada që nga ajo kohë, shumë më tepër është thënë dhe është shkruar për pikat e dobëta të teorisë së evolucionit dhe, përkundër propagandës së disa organizatave aktive në promovimin e dogmave evolucioniste, shkencëtarët kryesorë që e kanë kundërshtuar evolucionin nuk janë as të paditur, as shumë pak të kualifikuar. Në fakt, shumë prej tyre, duke i bërë doktoraturat në Universitetet kryesore në botë, dhe duke kaluar shumë vite për të bërë kërkime shkencore mbi këtë temë, kanë njohuri shumë të detajuar për këto çështje. Në të vërtetë, është përvoja ime se, në shumë raste ata janë më të informuar për teorinë e evolucionit nga disa evolucionistë. Pikërisht këtyre personave iu jam shumë borxhli, dhe, për aq sa lexuesi do ta gjejë këtë libër të vlefshëm, kjo është pikërisht për shkak të punës së madhe të këtyre shkencëtarëve. Në mënyrë të veçantë për t’u lavdëruar për punën e tyre të përpiktë dhe pioniere janë: Instituti për Kërkime mbi Krijimin, Përgjigjet të Zanafilla dhe Shërbesat Ndërkombëtare për Krijimin. Faqet e internetit për këto organizata kreacioniste\* jepen më poshtë<sup>1</sup>.

Përgjithësisht unë nuk shkruaj për tema që janë të mbuluara mirë tashmë, dhe tani ka shumë materiale të shkëlqyera, që kanë të bëjnë me debatin krijimi / evolucionit, që janë në dispozicion si libra ose në internet. Megjithatë, kur i nisa shqyrtimet e mia, nuk isha në gjendje të gjeja një përmbledhje të shkurtër të argumentave të prezantuar në mbështetje të teorisë së evolucionit, së bashku me arsyet se përse këto argumente janë kundërshtuar nga një numër gjithnjë

\* Që mbështetin teorinë e krijimit.

## Hyrje

në rritje i shkencëtarëve të mirinformuar. Pikërisht këtë gjë jam përpjekur ta jap kryesisht këtu në këtë libër.

Kërkimi shkencor mbi këtë temë ka qenë një nga zbulimet më të mëdha në jetën time.

**Dominik R. Statham**

Maj 2009

### **Shënime**

- 1 Instituti për Kërkime mbi Krijimin: [icr.org](http://icr.org);  
Përgjigjet te Zanafilla: [answersingenesis.org](http://answersingenesis.org);  
Shërbesat Ndërkombëtare për Krijimin, [creationontheweb.com](http://creationontheweb.com);  
Shoqëria Biblike për Krijimin: [biblicalcreation.org.uk](http://biblicalcreation.org.uk);  
Shërbesat Biblike për Krijimin: [biblicalcreationministries.org.uk](http://biblicalcreationministries.org.uk);  
Lëvizja Shkencore për Krijimin: [csm.org.uk](http://csm.org.uk);  
E Vërteta në Shkencë: [truthinscience.org.uk](http://truthinscience.org.uk);  
Grup Studimi për Biologjinë: [creationbiology.org](http://creationbiology.org).